



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Ministria e Financave**  
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE**

---

Adresa: Rr. e Durresit, Laprake - Tirane

Tel 243920, 243921, Fax 256547

Nr. 8757 Prot.

Tirane, me 14/07/2009

**U D H E Z I M**

**Nr. 01, date 14. 07. 2009**

**Mbi zbatimin e procedurave te miratimit dhe mbikqyrjes se Magazinave te Lira per karburantet ne Portet e Lendeve Djegese**

Mbeshetur ne nenet 183 - 196 te Ligjit Nr. 8449, date 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar dhe pikat 442 – 472 te Vendimit Nr.205, date 13.04.1999 te Keshillit te Ministrave "Per Dispozitat Zbatuese te Kodit Doganor", i ndryshuar;

Me qellim, saktesimin dhe zbatimin korrekt te procedurave doganore qe mundesojne miratimin dhe mbikqyrjen konform dispozitave doganore ne fuqi te aktivitetit te magazinave te lira te karburanteve ne Portet e Lendeve Djegese, ne territorin e Republikes se Shqiperise;

Bazuar ne piken 472 te Dispozitave Zbatuese te Kodit Doganor, Drejtori i Pergjithshem i Doganave,

**U D H E Z O N :**

**Neni 1  
Perkuqizime**

Per qellime te ketij Udhezimi:

1. "Magazine e Lire" do te quhet ambjenti i vendosur ne territorin doganor dhe i veçuar nga pjesa tjeter e tij me rrethim dhe kushte te larta sigurie ne te cilen magazinohen:

- mallra joshqiptare qe, per qellim te zbatimit te detyrimeve te importit dhe/ose masave te politikes tregtare te importit, konsiderohen se nuk kane hyre ne territorin doganor sipas kushteve qe percakton legjislacioni doganor;

- mallra shqiptare te cilat me dispozita te vecanta, perfitojne nga masat e eksportit, per shkak te vendosjes se tyre ne nje magazine te lire.

2. “*Operator*” do te quhet çdo person qe ushtron aktivitetin ne drejtim te ruajtjes, punimit, perpunimit, shitjes ose blerjes se mallrave ne nje magazine te lire.

## Neni 2

### Procedurat qe lidhen me miratimin e aktivitetit te Magazines se Lire

1. Ministri i Financave, ne zbatim te nenit 184 te Kodit Doganor, eshte autoriteti qe autorizon krijimin dhe zhvillimin e aktivitetit te Magazinave te Lira.

2. Kërkesa per miratimin e aktivitetit te magazines se lire paraqitet me shkrim nga operatori prane Drejtorit te Pergjithshem te Doganave.

3. Kërkesa shoqerohet nga dokumentacioni i nevojsphem mbi bazen e te cilit gjykohet per nevojen ekonomike te perdorimit te magazines se lire dhe zbatimin e kritereve te percaktuara per mundesite e ruajtjes, sigurise dhe zhvillimin e aktivitetit tregtar ne kushte optimale.

Ky dokumentacion perbehet nga:

- kopje te dokumentacionit ligjor te shoqerise qe kerkon te administroje nje magazine te lire.
- Raport i hollesishem mbi pershkrimin e aktivitetit importues dhe tregtar te shoqerise si dhe atij qe parashikon te kryhet.
- Kopje te dokumentacionit te pronesise se ambjenteve te propozuara per magazine te lire.
- Planimetri e objektit e shoqeruar me raportin qe prezanton kushtet dhe masat per ruajtjen, vezhgimin, sigurine e ambjenteve dhe mallrave qe do te magazinohen, pikat (portat) e hyrjes dhe daljes se mallrave, mundesite per mbyllje me dryn ose plumbosje nga autoritetet doganore. Raporti mund te shoqerohet me materiale fotografike ose filmike.
- Prezantimi i sistemit mates (te aparaturave matede) qe mundeson verifikimin fizik te sasise gjendje ne çdo moment qe do te kerkohet nga autoritetet doganore.
- Lista e mjeteve qe disponon operatori per plotesimin e nevojave te ushtrimit te aktivitetit ne magazine dhe qe lidhen me trajtimet, perpunimet, matjet, transportin, kontrollin, ruajtjen dhe sigurine.
- Dokumentacioni qe verteton shkallen e besueshmerise ndaj organeve fiskale dhe ligjore.

4. Me marrjen e kërkeses dhe dokumentacionit shoquerues, Drejtori i Pergjithshem i Doganave, urdheron ngritjen e nje komisioni me jo me pak se 3 (tre) specialiste te Departamentit Teknik, per shqyrtimin e dokumentacionit dhe verifikimin ne vend te kushteve te prezantuara ne kerkese.

- a) Komisioni i ngritur, pas shqyrtimit te dokumentacionit dhe verifikimit te ambjenteve nderton nje raport mbi shkallen e zbatueshmerise se kerkesave ligjore te nevojshme per zhvillimin e aktivitetit normal te magazines se lire.
- b) Nese shihet e nevojshme propozon masa te tjera qe mundesojne permiresimin e sistemit te propozuar per ruajtje, vezhgim dhe mbikqyrje doganore.

c) Ne varesi te rezultatit te verifikimit i sugjeron Drejtorit te Pergjithshem te Doganave vijimin ose jo te procedurave te metejshme qe lidhen me miratimin e Magazines se Lire.

d) Ne rastet kur komisioni sugjeron vijimin e procedurave te miratimit Drejtoria e Procedurave dhe Vjetes Doganore dhe Borxhit perpilon Autorizimin perkates sipas aneksit bashkangjitur ketij Udhezimi.

5. Me tej Drejtori i Pergjithshem i Doganave percjell autorizimin dhe dosjen me te gjithe dokumentacionin e siperpermendur per miratim prane Ministrit te Financave.

### **Neni 3**

#### **Procedura specifike qe lidhen me mbikqyrjen, vezhgimin dhe kontrollin e magazines se lire**

1. Pas marrjes se miratimit per zhvillimin e aktivitetit ne magazinen e lire, operatori paraqet prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, kerkesen me shkrim per miratimin e regjistrave te magazines, ne perputhje me nenin 192 te Kodit Doganor dhe pikave 448 – 450 te Dispozitave Zbatuese te Kodit Doganor.

2. Pas marrjes se miratimit te regjistrave te magazines, operatori nis veprimtarine ne magazinen e lire.

3. Regjistrat e magazines se lire duhet te permbajne te gjitha te dhenat e nevojshme qe mundesojne mbikqyrjen doganore dhe qe percaktohen ne piken 458/3 te Dispozitave Zbatuese te Kodit Doganor.

4. Gjate ushtrimit te aktivitetit, operatori eshte i detyruar te regjistroje dhe dokumentoje te gjitha hyrjet/daljet e mallrave ne magazinen e lire si dhe te paraqese prane autoriteteteve doganore te zyres mbikqyrese, per cdo rast, nje kopje te dokumentit te transportit apo te shkarkimit.

5. Autoritetet doganore te zyres mbikqyrese marrin te gjitha masat e nevojshme per zbatimin e procedurave doganore per hyrjen e mallrave, funksionimin e magazines se lire dhe daljen e mallrave nga magazina e lire konform rregullave te percaktuara ne pikat 452 – 472 te Dispozitave Zbatuese te Kodit Doganor.

6. Te gjitha veprimet per hyrjen dhe daljen e mjeteve dhe mallrave ne dhe nga magazina e lire jane objekt i njoftimit dhe lejes perkatese te autoriteteteve doganore te zyres mbikqyrese.

7. Keto veprime mund te kryhen vetem gjate orarit te percaktuar nga autoritetet doganore.

8. Autoritetet doganore te zyres mbikqyrese marrin te gjitha masat per mbulimin me personel te sherbimit doganor te nevojshem per vezhgim dhe mbikqyje te magazines se lire.

9. Dalja e mallrave nga magazina e lire, ne varesi te destinacionit doganor te percaktuar i nenshtrohet veprimeve doganore qe lidhen me depozitimin e deklarates, pranimin dhe verifikimin dokumentar e fizik.

10. Procedurat e zgjeruara qe zbatohen sipas kutise 37 te DAV-it permbajne detyrimisht kodin e procedures se meparshme 78 si psh:

4078 – import per konsum pas vendosjes ne magazine te lire

4178 – import per RPA me reimbursim pas vendosjes ne magazine te lire

3178 – rieksportim pas vendosjes ne magazine te lire, etj.

11. Ne menyre periodike mujore (brenda dates 5 te cdo muaji), operatori i magazines se lire dorezon prane autoriteteteve doganore te zyres mbikqyrese raport per gjendjen e mallrave ne magazine.

12. Autoritetet doganore te zyres mbikqyrese kryejne sistematikisht dhe ne menyre periodike (cdo 3-mujor) inventare te gjendjes fizike te mallrave duke krahasur me gjendjen sipas regjistrave te magazines.

**Neni 4**  
**Hyrja ne fuqi dhe zbatimi**

1. Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

2. Ngarkohet autoritetet perkatese doganore per njohjen dhe zbatimin me korrektesi te dispozitave te ketij Udhezimi.

**Endri PEMA**

**DREJTOR I PERGJITHSHEM**